

GJL nr.1187/2012

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCY AGAINST CORRUPTION	
Num. DPK/DMP	No. Pika
DPK/DMP	03-4270/12
02	26.11.2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Mejreme Zekaj dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Zymrije Çunaku, duke vendosur sipas ankesave të paraqitura nga Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë dhe i pandehuri Agron Bacaj nga Fsh.Zajm Komuna e Klinës, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.nr.4098/12, të datës 05.10.2012, në bazë të nenit 39,219 dhe 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 31.10.2012 merr

AKTVENDIM

Ankesat e paraqitura janë të **BAZUARA**.

ABROGOHET aktvendimi i atakuar dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, sipas aktvendimit Regj.nr.4098/12, të datës 05.10.2012, të pandehurin Agron Bacaj nga fsh.Zajm Komuna Klinë, e ka shpallur përgjegjës sepse nuk e ka bërë deklarinimin e rregullt vjetor të pasurisë në afatin ligjor, si zyrtar i lartë publik gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, Këshilltarë Komunal edhe pse ka qenë i obliguar që ta bëjë për vitin 2012 prej datës 1 deri më 31 mars, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6.1.1 në bazë të nenit 1.1 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Kontrollim e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë, dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 150.-€ (Njëqind e pesëdhjetë euro), duke e obliguar që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën paushalle prej 5.-€ (Pesë euro).

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë ka paraqitur ankesë për shkak të:

-vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se gjykata e shkallës së parë e ka shqiptuar dënimin prej 150.-€ në kundërshtim me nenin 17.1.3 (1500-2500 €) të Ligjit nr.04/L-050 ndaj të pandehurit për kundër kërkesës së Agjencisë e cila paska bërë kualifikimin juridik në pajtim me ligjin e lartpërmendur. Thekson se dënimin e ka zbutur në masë të madhe në vështirim të nenit 9 të LK-së, kështu që paska ardhur në kundërshtim me këtë nen andaj propozon që aktvendimi i atakuar të abrogohet dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Agron Bacaj ka paraqitur ankesë,

-vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike,

-aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe

-vendimit mbi dënimin.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se Këshilltarët e Kuvendeve Komunale deri më tani i kanë plotësuar formularët për deklarinimin e pasurisë vetëm në momentin kur janë zgjedhur, pra në fillim të mandatit dhe jo çdo vit kalendarik, se nuk e ka ditur për obligimin e plotësimit të këtij formulari ngase nuk ka marr kurrfarë njoftimi nga organi ku shërben. Më tutje thekson se për këtë obligim të deklarinimit të pasurisë ka qenë i njoftuar më datën 30 mars 2012 dhe jo më përpara kështu që teknikisht e ka pas të pamundur që formularin ta plotësojë dhe dorëzojë brenda fatit por sidoqoftë formularin e ka plotësuar dhe të njëjtin e ka dorëzuar personalisht në Agjencion më 24.04.2012, andaj propozon që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar kurse ky si i pandehur të lirohet nga fajësia dhe dënimi i shqiptuar.

2.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e atakuar, deklarin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 27.09.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ankesat e paraqitura i aprovoi si të bazuara, kurse aktvendimin e atakuar e abrogoi dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji vendosi për abrogimin e aktvendimit të atakuar për shkak të:
-shkeljes esenciale të dispozitave procedurale kundërvajtëse dhe
- vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike.

Shkeljet procedurale kanë të bëjnë me faktin se gjykata e shkallës së parë ka marr aktvendim në kundërshtim me kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse e ngarkon të pandehurin për mos deklarim të pasurisë nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe nga neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 dhe i propozon gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ta ndëshkoj në vështrim të nenit 17 paragrafi 1.3 të të njëjtit Ligj, që do të thotë se kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse të pandehurit i vë në barrë kundërvajtjen mosdeklarim i pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë nen 6 1.3, duke e mbështetur me nenin 9 të të njëjtit Ligj i cili skjaron se i pandehuri nuk ka vepruar për ta deklaruar pasurinë sipas kërkesës së Agjencisë dhe propozimi që ti shqiptohet ndëshkim në bazë të nenit 17 1.3 të të njëjtit Ligj pra për mos deklarim të pasurisë me kërkesën e Agjencisë, derisa në dispozitiv të aktvendimit i pandehuri është shpallur përgjegjës për shkak se nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë për vitin 2012 ? në vështrim të nenit 6 1.1 dhe 17 1.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, e që është në kundërshtim me ate për çka e ngarkon kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ka të bëjë me faktin se i pandehuri në deklaratën e dhënë pranë gjykatës së shkallës së parë e konteston kundërvajtjen e cila i vëhet në barrë duke deklaruar se formularin për deklarimin e pasurisë e ka marr me vonesë për çka edhe plotësimin dhe dorëzimin e të njëjtit e ka bërë me vonesë dhe gjykata e shkallës së parë këtë deklarim të të pandehurit e konsideron si pranim duke e shpallur përgjegjës dhe duke i shqiptuar dënim në vështrim të nenit 9 të LK-së, por duke mos e arsyetuar as aplikimin e nenit 9 të LK-së, me rastin e shqiptimit të gjobës nën minimumin e paraparë ligjor njëherit duke mos administruar asnjë provë tjetër.

Në plotësim procedure gjykata e shkallës së parë, duhet të veproj sipas vërejtjeve të theksuara më lartë, të merr në pyetje ushtruesin e kërkesës i cili (bazuar në kërkesën e ushtruar) do të dëshmoj se kur dhe si ka kërkuar nga i pandehuri që të bëjë deklarimin e pasurisë në vështrim të neneve 6 1.3, 9 dhe 17 1.3 të Ligjit nr.04/L-050, njëherit duke pasur parasysh dhe vërtetimin e lëshuar nga Agjencia kundër Korrupsionit me të cilin dëshmohet se i pandehuri më 24.04.2012 e ka dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë të administroj edhe prova tjera eventuale dhe më në fund varësisht nga vërtetimi i gjendjes faktike të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.


Nga sa u tha më lartë, konform të nenit 222 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

GJL.nr.1187/2012, të datës 31.10.2012.

SEK. JURIDIKE,
Zymrije Cunaku



KRYETARI I KOLEGJIT,
Dalip Bega